



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2020:166256
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05514732
C.nr.528/2020

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Avdulla Mecinaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.D. nga fshati..., komuna Skenderaj, me nr. personal... te cilin e përfaqëson sipas autorizimi Sh.I. avokat ne Skenderaj, Rr..., kundër të paditurit B.Th. nga fshati..., komuna Skenderaj, tani me vendbanim Rr... ne..., komuna Mitrovicë, për vërtetim pronësie ne bazë te shitblerjes se paluajtshmërisë, jashtë seancës gjyqësore , me dt.27.03.2024 jep këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET kërkesëpadia e paditësit I.D. nga fshati... komuna Skenderaj.

II. VERTETOHET se paditësi I.D. është pronar nga baza e shitblerjes ne pasurin e paluajtshme e evidentuar si ngastër kadastrale nr... me kulturë arë ne vendin e quajtur... me sipërfaqe prej 5115 m2, zona kadastrale... komuna Skenderaj,

III. DETYROHET i padituri B.Th. t'ia njej të drejtën e pronësisë paditësit I.D., dhe te lejojë qe kjo e drejte te regjistrohet ne librat publike kadastrale ne Drejtorin për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë ne Skenderaj, ne afat prej 15 dite nga dita e marrjes se këtij aktgjykimi e nen pasojat e procedurës përmbartimore.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi I.D. në këtë gjykatë ka parashtruar padi me dt:26.11.2020 kundër të paditurit B.Th. për vërtetim pronësie nga baza e shitblerjes se paluajtshmërisë.

Nga referati i padisë theksohet se paditësi pasurinë e paluajtshme e ka blere nga prindi i te paditurit dhe ka marrë për obligim bartjen e pronësisë ne emrin e tij por ne ndërkohe ka vdekur dhe paditësi e ka ne shfrytëzim dhe mbajtje te pa ndërprerë ketë paluajtshmeri, pasi qe e kishte paguar çmimin e shit blerjes pra është ne posedim te qetë dhe faktikë mirëpo ka interes juridik qe kjo paluajtshmeri te bartet ne emrin e tije me propozim gjykatës qe te aprovohet kërkesë padia ne tersi si e bazuare.

I padituri ne përgjigje ne padi te dorëzuar ne gjykatë ka deklaruar se bazuar ne gjendjen faktike kjo padi është e bazuar ne tersi dhe ne petitumin e te njëjtës te dhënat janë te vërteta pasi qe është

fakte që kanë pasuri të paluajtshme paditësi e ka blerë nga prindi imë dhe prej atë momenti të shitblerjes e ka në shfrytëzim të qete dhe mbi këtë bazë unë nuk e kontestoi padinë dhe kërkesë padinë e paditësit.

Gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm jep aktgjykim në bazë të pohimit në kuptim të nenit 143 paragraf 1, e lidhur me nenin 398 Ligji i Procedurës Kontestimore me të cilin e pranon si të bazuar kërkesë padinë.

Gjykata vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi pasi që vlerësoi se themelësia e kërkesë padisë është vërtetuar në faktet e treguara në padi mbi të cilat mbështetët kërkesë padia, pra nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi, si qeshtë certifikata e pronësisë nr.48810/23 të datës:14.09.2023 që vërtetohet se ngastrat kadastrale që është çështje shqyrtimi evidentohet në emrin Z.Th., si rrethana të vërtetuara nga i padituri pra ka legjitimitet pasivë të palës në procedurë pasi që i padituri e ka pohuar kërkesë padinë dhe ka lejuar që kjo prone të bartet në emër të paditësit.

Nga provat e pa kontestuar gjykata erdhi në përfundim se kërkesë padia e paditësit është e bazuar në kuptim të nenit 28 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore dhe nenit 36 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 160.6 të Ligji i Procedurës Kontestimore gjykata dha vetëm arsyet e marrjes së këtij aktgjykimi pa u lëshuar në arsyeshmerinë e secilës veç e veç e këtë për faktin se i padituri e ka pohuar kërkesë padinë e paditësit dhe me qen se kemi të bëjmë me kërkesë për të cilat palët mund të dispononi lirshëm e nuk janë në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 3 paragraf 3 i lidhur me nenin 148 paragraf 1 dhe neni 398 Ligji i Procedurës Kontestimore vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Për shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata vendosi në kuptim të nenit 450 të LPK-së, ashtu që secila palë i bart shpenzimet e veta në procedurë.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.528/2020 me dt.27.03.2024

Gjyqtari,
Avdulla Mecinaj

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite nga dita e marrjes, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.